



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 487/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

Arsyetim

Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) dega në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në ditën e zgjedhjeve në qytetin e Klinës, janë parë vetura të ndryshme të cilat vazhdimisht kanë shëtitur nëpër rrugë me fotografi të kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hashim Thaqi. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tre fotografi si dëshmi si dhe numrin e tel. të personit kontaktues Faton Tahiri.

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga LVV, duke pretenduar se në ditën e zgjedhjeve simpatizantët e PDK-së kanë thyer Kodin e Mirësjelljes duke bërë fushatë gjatë ditës së zgjedhjeve.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e LVV-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi në ditën e zgjedhjeve.

PZAP-i konsideron që LVV nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 487/2010 më datën 14.12.2010.



**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**